



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr. 402/148 Prot.

Tiranë, më 08/01/2025

Lënda : Publikim i vendeve vakant për personel akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Bazuar në Udhëzimin e Rektorit Nr.4, datë 02.07.2024 “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, njoftimin në faqen zyrtare të APP Nr.90, datë 30.12.2024 si dhe shkresën e Rektoratit UMT me Nr.Prot.3092/9, date 07.01.2025, Fakulteti i Mjekësisë Dentare hap fazën e dytë të konkurimit për vendet vakant, së bashku me kriteret e përgjithshme dhe preferenciale për personel akademik me kohë të pjesshme, si më poshtë :

KRITERE TË PËRGJITHSHME QË DUHET TE PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR PUNËSIM SI PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË FMD:

1. Të ketë përfunduar studimet në një program të integruar ose master shkencor dhe të jetë diplomuar në fushën përkatëse, në universitetet brenda ose jashtë vendit;
2. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkuron;
3. Të zotërojë me dëshmi një nga pesë gjuhët e huaja të BE (Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht);
4. Të ketë përfunduar studimet universitare për stomatologji me notë mesatare mbi 8;
5. Të jetë shtetas shqiptar;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje;
7. Të zotërojë gjuhë shqipe, të shkuar dhe të folur;
8. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
9. Të jetë në kushte shëndetësore që lejon kryerjen e detyrës përkatëse;
10. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe institucione të tjera të edukimit;
11. Aplikanti duhet të ketë së paku kualifikimin e ciklit pasardhës.

A. Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike **2 (dy) vende vakant**

KRITERE PREFERENCIALE :

1. Të ketë Doktoraturë ose Diplomë të përfundimit të Specializimeve Afatgjata në fushën përkatëse;
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në specialitetin përkatës;
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie 3 vite;
4. Të ketë license profesionale të ushtrimit të profesionit;
5. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në kërkim shkencor;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

B. Departamenti i Terapisë Stomatologjike **1 (një) vend**

KRITERE PREFERENCIALE :

1. Të ketë Doktoraturë ose Diplomë të përfundimit të Specializimeve Afatgjata në fushën përkatëse;
2. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në specialitetin përkatës;
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
4. Të ketë license profesionale të ushtrimit të profesionit;
5. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në kërkim shkencor;

C. Në Programet e Studimit Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare” :

- **Morfologji Dentare** **1 vend**
- **Njohuri Materiale** **1 vend**
- **Art i Modelimit** **1 vend**
- **Praktikë profesionale** **1 vend**

KRITERE PREFERENCIALE :

1. Të ketë eksperiencë pune në fushën përkatës;
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
3. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në kërkim shkencor;

D. Në Lëndët Mjekësore të FMD :

- **Fiziologji Patologjike** **1 vend**
- **Anatomi Normale** **1 vend**
- **Radiologji Orale** **1 vend**

KRITERE PREFERENCIALE :

1. Të ketë Doktoraturë ose Diplomë të përfundimit të Specializimeve Afatgjata në fushën përkatëse;
2. Të ketë eksperiencë pune në specialitetin përkatës;
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
4. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në kërkim shkencor;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Dosja e aplikantit për vendet vakant duhet të përmbajë këto dokumente :

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Fakultetit të Mjekësisë Dentare;
2. Curriculum Vitae, në të cilën të jetë detajuar veprimtaria shkencore dhe botues të kandidatit;
3. **Leje nga punëdhënësi në organizatën ose institucionin ku punon (nëse është i punësuar);**
4. Dokument identifikimi;
5. Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe të listës së notave të të gjithë programeve të studimit (Bachelor, Master Shkencor, Program të ciklit të tretë të studimeve- specializim afatgjatë në fushën përkatëse, Doktoraturë, Tituj Shkencor);
6. Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, duhet të depozitojnë fotokopje të noterizuar të njohjes së dokumentacionit të kërkuar më sipër, nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
7. Fotokopje të noterizuar të dëshmime të gjuhëve të huaja të mbrojtura (e detyrueshme të paktën një);
8. Fotokopje të noterizuar të Librezës së Punës;
9. Vërtetim page, shoqëruar me dokumentin e lëshuar nga e-albania për pagesën e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore/Shëndetësore;
10. Dëshmi penaliteti ;
11. Dy referenca nga të cilat të paktën njëra të jetë nga një profesor i institucionit në të cilin është diplomuar (dorëzohet vetëm nëse kandidati aplikon për here të pare);
12. Vërtetim i aftësisë në punë, i vlefshëm për tre muajt e fundit nga data e aplikimit për vendin e punës;
13. Çdo document tjetër që vërteton kriteret specifike dhe ato preferenciale të publikuara;
14. Dosja të jetë e shoqëruar me fletën e inventari ;

Aplikimet do të jenë pranë zyrës së Protokollit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare 7 shtatë ditë pune, nga data e publikimit në faqen zyrtare të FMD- <https://www.fmd.edu.al> dhe të UMT-së <http://www.umed.edu.al>

DEKANI
Prof. Asc. Silvana BARA

